



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

NJOFTIM

Në zbatim të Rregullores së Maturës Shtetërore, maturantët/kandidatët që kanë dhënë provimet e MSH 2025, sesioni i parë, kanë të drejtë të kërkojnë kopjen e testit, pas përfundimit të të 4 (katër) provimeve të MSH.

Maturanti/kandidati që kërkon kopjen e testit, duhet të kryejë aplikimin online në portalin e-albania, duke përdorur shërbimin “**Aplikim për kopje testi të Maturës**”, për të 4 (katër) provimet, **në datën 01 korrik 2025, ora 08.00 – 16.00.**

Pas trajtimit të kërkesës, QSHA do të nisë kopjen e testit për secilin maturant/kandidat që e ka kërkuar atë, në “Hapësira ime”, seksioni “Dokumentet e mia”, në llogarinë përkatëse të çdo maturanti/kandidati, në e-albania.